

VENDIM
Nr. 113, datë 6.3.2019

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË PËRFAQËSOJNË PALËN SHQIPTARE NË
KOMISIONIN SHQIPTARO-MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME
INTERES TË PËRBASHKËT**

(Ndryshuar me VKM nr. 604, datë 25.10.2023; nr. 286, datë 28.5.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në komisionin shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët, në zbatim të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, të përbërë, si më poshtë vijon:

- | | | |
|-----|--|----------|
| a) | Znj. Anila Shehu, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | kryetar; |
| b) | Z. Arben Mukaj, Ministria për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural | anëtar; |
| c) | Z. Alfred Çerepi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; | anëtar; |
| ç) | Z. Klodian Zaimi, Instituti i Gjeoshkencave; | anëtar; |
| d) | Z. Kristaq Qirko, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor | anëtar; |
| dh) | Z. Ermal Kacurri, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare | anëtar; |
| e) | Znj. Sonila Marku, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar | anëtar; |
| ë) | Znj. Neritan Postoli, Agjencia Kombëtare e Mjedisit | anëtar; |
| f) | Z. Besmir Kullolli, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; | anëtar; |
| G) | Znj. Xhemi Jaupaj, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | anëtar. |

2. Punët administrative për nevojat e komisionit, për palën shqiptare, do të kryhen nga Agjencia e

Menaxhimit të Burimeve Ujore.

3. Anëtarët e komisionit shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët raportojnë, në mënyrë periodike, për veprimtarinë e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe